



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 07.04.2015, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Slavko Simiq, Mytaher Haskuka dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Sakibe Jashari, Ambasada e Zvicrës; Lejla Selimi – OSBE; Jetmir Bakija-KDI; Uke Gashi-ZRPK; Visar Bivolaku-EUO/EUSR; Gentiana Kadrij-Kosovapress dhe Arta Xhylani-praktikante, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 08;
3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për peticionin për zbardhjen e fatit të Mr.Ukshin Hotit;
4. Shqyrtimi i peticionit nr. 05/525/Do-372;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 08

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19 mars 2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për petitionin për zbardhjen e fatit të Mr. Ukshin Hotit

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues ka ofruar një raport me rekomandime dhe ia dha fjalën znj. Mexhide Mjaku – Topalli lidhur me sqarimet e më tutjeshme.

Mexhide Mjaku – Topalli, duke u ndërlidhur me çështjen, theksoi se grupi punues ka mbajtur dy aktivitete. Aktiviteti i parë që ajo përmendi, ishte takimi me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur, si dhe takimi në Komision ku kanë qenë prezentë qytetarët e Rahovecit, respektivisht parashtruesit e petitionit dhe përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur. Në vazhdim, ajo theksoi se kidnapimi i Mr. Ukshin Hotit është bërë në mënyrë të planifikuar nga strukturat ushtarake shtetërore të Serbisë, në rrethana të qarta. Ajo tha se në këtë raport kanë listuar katër pika, të cilat i lexoi të gjitha, ashtu siç janë paraqitur në raport. Pasi i lexoi të gjitha rekomandimet e paraqitura në raport, theksoi se e kërkon mendimin e Komisionit për përmirësime eventuale dhe miratimin e tyre, në mënyrë që këto të paraqiten në seancë plenare dhe të debatohet në Kuvend apo të nxirret ndonjë akt në formë të rezolutës.

Etem Arifi, duke u ndërlidhur me rekomandimin nr. 3, ngriti çështjen e borxheve të Qeverisë së Kosovës në laboratorin e Tuzllës, sepse si pasojë e kësaj, nuk janë kthyer analizat e AND-së. Ai kërkoi që të kërkohet përgjigje nga Qeveria rreth kohës që ka pasur borxhe të kësaj natyre ndaj laboratorit të lartcekur. Lidhur me këto raste, ai kërkoi që të bëhet më shumë trysni tek Qeveria, që në të ardhmen mos të ketë borxhe të tilla, si pasojë e të cilave ende nuk janë kthyer analizat e AND-së, për të cilat janë në pritje familjarët e personave të zhdukur.

Mexhide Mjaku – Topalli, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit, sqaroi se për këtë çështje nuk ka qenë buxheti i shtetit, por ka qenë një fond nga jashtë, dhe pikërisht për këtë, propozoi që të diskutohet çështja në Kuvend, në mënyrë që të gjenden fondet për pagesat e këtyre analizave.

Kryetarja, tha se kjo nuk ndërlidhet me çështjen e zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit dhe nuk është me vend që të diskutohet për këto rekomandime.

Teuta Haxhiu, duke diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, kërkoi që në takimin e ardhshëm të ftohet në mbledhje të Komisionit dr. Arsim Gërxhaliu, sepse siç tha ajo, janë të nevojshme informacionet nga ai. Këtë ajo e arsyetoi me informacionet që ka rreth Departamentit të Mjekësisë Ligjore për mosfunksionimin në rregull të tij, sepse sipas informacioneve që ajo ka, disa të dhëna janë kontradiktore me atë që ka deklaruar z. Prenk Gjetaj në takimin e kaluar. Për këtë arsye, ajo tha se me të dhënat që do t'i ofrojë z. Gërxhaliu, do të sqarohen disa çështje të cilat janë shqetësuese për të dhe për të tjerët. Ajo ishte e mendimit që njëherë mos të shkojnë rekomandimet për Kuvend dhe propozoi që si pikë shtesë në këto rekomandime të ishte detyrimi për zbatimin e rekomandimeve të interpelancës, që është mbajtur në vitin 2012. Lidhur me takimin e ardhshëm, propozoi që të ftohet z. Arsim Gërxhaliu dhe kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, z. Prenk Gjetaj.

Kryetarja, tha se këto rekomandime kanë të bëjnë me petitionin për zbardhjen e fatit të Mr. Ukshin Hotit dhe mos të ngatërrohen me çështje të tjera. Ajo, po ashtu, informoi se do të mbahet një seancë e veçantë lidhur me personat e zhdukur dhe në këtë seancë deputetët do të kenë mundësinë që t'i paraqesin shqetësimet e tyre. Duke u ndërlidhur me rekomandimet e raportit të grupit punues, kërkoi që të sqarohet periudha kohore, brenda të cilës Qeveria do të raportojë në Kuvend lidhur me të arriturat në bisedimet me palën serbe për fatin e personave të zhdukur. Po ashtu, tek rekomandimi që flet për kuadrot profesionale dhe investimi i Qeverisë për krijimin e këtyre kuadrove, ishte e mendimit që ky rekomandim duhet të riformulohet.

Salihe Mustafa, kërkoi që të sqarohen se a do t'i miratojnë rekomandimet para se të deklaroi z. Gërxhaliu në takimin e ardhshëm apo do të miratohen pas deklarimit të tij, sepse rekomandimet do të ishin më konkrete, pra pasi të dëgjohet z. Gërxhaliu.

Kryetarja, kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit, nëse do të vendosin që miratimi i rekomandimeve të bëhet pas deklarimit të z. Gërxhaliu. Ajo tha se kjo çështje mos të vazhdojë të debatohet sot, pra të shqyrtohen dhe miratohen pasi që të përfundojë takimi me z. Gërxhaliun.

Kujtim Paqaku, diskutoi rreth rekomandimit nr. 3, kërkoi informacione se a kanë ndonjë petition të familjarëve të të zhdukurve të Qabratit apo pritjet arritja e ndonjë peticioni të tillë, në mënyrë që të shtjellohet edhe ky rast dhe të analizohen shkaqet e mospagesës së analizave dhe vonesës së tyre.

Kryetarja, theksoi se sot si pikë e rendit të ditës është vetëm peticioni për zbardhjen e fatit të Mr. Ukshin Hotit.

Teuta Haxhiu, duke diskutuar për rekomandimet që kanë dalë nga interpelanca e vitit 2012, ishte e mendimit që të futet rekomandimi nr. 1 në tërësi, ose si pjesë e këtyre rekomandimeve të jetë obligimi i zbatimit të rekomandimeve të dala nga interpelanca. Në të kundërtën, ajo tha se nuk pajtohet që rekomandimet të shkojnë në mënyrë tjetër.

Mexhide Mjaku – Topalli, në cilësinë e udhëheqëses së grupit punues për këtë çështje, duke u ndërlidhur me rekomandimin nr. 3, u pajtua që ky rekomandim të hiqet dhe të zëvendësohet me një rekomandim tjetër.

Kryetarja, u pajtua me këtë dhe theksoi se formulimi i rekomandimit duhet të bëhet në bazë të diskutimeve në takim. Lidhur me riformulimin e rekomandimeve, tek pjesa e rekomandimeve që flitet për raportimin e Qeverisë në Kuvend, pra për të arriturat në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ajo propozoi që raportimet e Qeverisë të bëhen në faza gjashtëmujore.

Teuta Haxhiu, duke u ndërlidhur me riformulimin e rekomandimeve, ishte e mendimit që si Komision, të kërkojnë që në takimin e parë të radhës, çështja e të pagjeturve të jetë temë e debatit.

Kryetarja, lidhur me këtë theksoi se nëse ata kërkojnë nga Qeveria që në periudha kohore prej 6 muajve Qeveria të raportojë në Kuvend për këtë çështje, do të jetë e mjaftueshme që të marrin informacione për të arriturat në këtë fushë. Pas këtij debati, kryetarja e lexoi rekomandimin e riformuluar si vijon:

- Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë bisedimeve Kosovë – Serbi, të kërkojë që të përfshihet në agjendën e bisedimeve në faza gjashtëmujore, zbardhja e fatit të personave të zhdukur dhe raportin lidhur me të arriturat në këtë drejtim dhe ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Qeveria e Republikës së Kosovës të sigurojë dhe të përgatisë kuadro profesionale dhe mekanizma teknikë adekuatë për punë më efikase për identifikimin e mbetjeve mortore dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Salihe Mustafa, kërkoj që të precizohen çështjet e këtyre rekomandimeve, sepse sipas deklarimeve të saj, rekomandimet po marrin kahe të përgjithshme dhe nuk po prekin çështjen konkrete, që ka të bëjë me peticionin e rastit për Mr. Ukshin Hotin.

Teuta Haxhiu, pasi që mori informacione rreth kohës së procedimit të peticionit, në këtë rast, ajo sërish kërkoj që këto rekomandime të bëhen pas takimit që do të bëhet me z. Gërxhaliu.

Kryetarja, pas këtij debati theksoi se plotësimi i të dhënave, me qëllim që rekomandimet të jenë më të kompletuara, të mbetet për takimin e radhës, në të cilin do të ftohet z. Gërxhaliu.

Pas debatit, u vendos që në takimin e ardhshëm të ftohet Arsim Gërxhaliu, me qëllim të dhënies së informative për çështjen e personave të pagjetur.

4. Shqyrtimi i peticionit nr. 05/525/Do-372

Kryetarja, i njoftoi anëtarët e Komisionit me përmbajtjen e këtij peticioni. Me qëllim që informacioni të jetë sa më i plotë lidhur me këtë peticion, ajo e lexoi në tërësi peticionin në fjalë.

Teuta Haxhiu, duke u ndërlidhur me peticionin në fjalë, tha se edhe përkundër faktit se kjo është e dhimbshme, mirëpo kjo çështje nuk bie në kompetencë të Komisionit.

Kryetarja konstatoi se pas një debati lidhur me peticionin, Komisioni nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, pasi e shqyrtoi peticionin nr 05 / 535, konstatoi se kjo çështje nuk bie në kompetencë të tij.

6. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit për punëtorinë e mbajtur në Bogë, me qëllim të hartimit të udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve. Lidhur me këtë, ajo theksoi se materialin e kanë në kuti dhe brenda një kohe, ata mund të japin mendimet e tyre konkrete lidhur me plotësime eventuale të udhëzuesit. Ndërsa, sa i përket pikës së rendit të ditës së Seancës plenare, që kishte të bënte me peticionin kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike, me një konsensus të anëtarëve të Komisionit, është shtyrë për shkak se ka arritur raporti i Rregullatorit të Energjisë Elektrike, raport ky i cili iu ndihmon në pasurimin e informacioneve dhe për këtë arsye është parë e arsyeshme që ky shqyrtim të bëhet në një nga takimet e ardhshme.

Salihe Mustafa, duke u ndërlidhur me parafolësen, theksoi se janë dakorduar që të shtyhet shqyrtimi i kësaj pike për një takim të radhës, për arsye se në njërin nga pikat ka qenë që Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike të sjellë raport, gjë që e ka bërë, dhe pikërisht për këtë shkak, janë dakorduar që kjo çështje të shtyhet për një takim të ardhshëm. Po ashtu, tha se në seancë ka rezultuar që rekomandimet që janë paraqitur, nuk kanë qenë të Komisionit.

Teuta Haxhiu, duke u bashkangjitur në këtë debat, theksoi se ka kërkuar që të shtyhet kjo pikë, me qëllim që të marrin informata shtesë brenda Komisionit, ndërsa sa i përket raportit, ajo tha se raporti është pikë e veçantë e seancës dhe për këtë diskutohet veçanërisht. Ajo nuk ishte e mendimit që Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qenë i obliguar që të nxjerrë rekomandime lidhur me këtë çështje, për arsye se Komisioni për të Drejtat e Njeriut nuk ka kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që të nxjerrë rekomandime.

Kryetarja, tha se secili komision e ka fushëveprimin e vet dhe Komisioni për Buxhet, në ato raste kur ka të bëjë me implikime buxhetore, nxjerr rekomandime konkrete, sepse është komision kryesor dhe rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut kanë dalë nga përfundimet që janë marrë në Komision.

Teuta Haxhiu, pyeti se a përfundon puna e Komisionit për të Drejtat e Njeriut për këtë çështje, me rekomandimet që i ka nxjerrë dhe a janë votuar këto rekomandime në Komision, sepse nuk jam në dijeni se kemi votuar këto rekomandime në Komision.

Salihe Mustafa, e përsëriti se në seancë është ngritur çështja që rekomandimet, për të cilat po debatohen në Komision, nuk janë proceduar nga Komisioni, mirëpo janë kontrabandë. Lidhur me këtë, tha se nuk guxojmë që ne si Komision të dalim në këtë mënyrë.

Teuta Haxhiu, tha se rekomandimet duhet gjithmonë të votohen në Komision, para se të procedohen për në Kuvend.

Kryetarja, përsëriti edhe një herë se rekomandimet kanë dalë nga përfundimet dhe nga ajo se çka është diskutuar në Komision, dhe i keni pasur me kohë. Nëse keni pasur vërejtje, është dashur të më sinjalizoni, për t'u mbledhur edhe një herë si Komision për të diskutuar, e jo të dilet në seancë me fjalime të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi